

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

Ka mbi një muaj që, jo vetëm në SHBA, por në të gjithë botën, po gëlon lajmi rreth një skandali të përmasave botërore. Një skandal që krahasohet me “Watergate”-in e dikurshëm dhe në këtë skandal është i përfshirë Kryeministri i Shqipërisë, vetë naltgjatësia e tij, Edi Rama. Kemi mbi një muaj këtu që përpiqemi të vijë dita e bërjes së debatit, që Kryeministri t’u përgjigjet pyetjeve dhe të vazhdohet, të respektohet Rregullorja dhe Kushtetuta për të ngritur komisionin hetimor. Por kjo nuk po ndodh, madje edhe sot që erdhi, zonjë, iku. Erdhi, cicëroi dhe iku. Kjo është seancë me debat dhe zotëria e tij duhej të ishte këtu në respekt të këtyre deputetëve, se për pjesën këtej nuk ka respekt, por, të paktën, për të vetët, dhe në respekt të parlamentit si institucion, në respekt të ligjeve, të Kushtetutës dhe të qytetarëve të këtij vendi. Ai duhej të ishte këtu, por Edi Rama e di shumë mirë se nuk mund të rrijë më këtu, sepse ai ka një hall të madh. U përpoq të recitonte aktakuzën me kujdesin më të madh, që të mos bënte gabim të kthente përgjigje për asnjë nga pyetjet që i janë drejtuar, sepse e di shumë mirë që në të dyja dosjet që po hetohen në SHBA, njëra prej tyre ka të bëjë vetëm dhe vetëm me Edi Ramën, sepse Edi Rama ka bërë atë që nuk ka guxuar ta bëjë askush që kur është themeluar shteti shqiptar në këtë vend. Ky njeri, i dashuruar deri në marrëzi me vetveten, një nga megalomanët më të mëdhenj që ka prodhuar ndonjëherë ky vend, tani përpiqet të luajë rolin e viktimës për të fshehur krimin dhe korrupsionin, për të fshehur dhe manipuluar gjithçka përballë drejtësisë amerikane.

Sot shqiptarët dhe të gjithë të tjerët e dinë që pas Enver Hoxhës, antiamerikani më i madh që ka pasur ky vend e ka emrin Edi Rama, sepse askush pas Enver Hoxhës nuk ka guxuar të godasë institucionet e shtetit amerikan. Sot, ky njeri është armiku më i madh i Amerikës; ky njeri, i cili u shit si aleati dhe partneri më i madh i Amerikës, sot është i trembur nga Amerika, por edhe nga ne, nga shqiptarët dhe nga Shqipëria, sepse e vërteta është e qartë dhe askush nuk i beson dokrrat dhe përrallat. Prokurori i Përgjithshëm i SHBA-ve e tha mbrëmë qartë: “Nëse dikush paguan, pra korrupton një nëpunës, ai ka cenuar sigurinë kombëtare të SHBA-ve”. Edi Rama po hetohet sot në SHBA se ka cenuar sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjë që e ka futur atë në panik dhe e ka bërë të jetë kaq i kujdesshëm sot, duke mos u përgjigjur për asgjë. E vërteta është që McGonigal u përdor për të sulmuar, shantazhuar dhe likuiduar PD-në dhe opozitën, përndryshe Edi Rama duhet t’u përgjigjej pyetjeve se çfarë kishte ai; çfarë diskutoi më 9 shtator të vitit 2017, se kjo është kronologjia; çfarë diskutoi me McGonigal-in; pse ia solli Duçka në zyrë; kush ishte Duçka? Duçka është një CEO i një kompanie kineze, e cila është nën sanksionin e SHBA-ve, i cili u emërua këshilltar i Kryeministrit dhe iu dha pasaportë diplomatike, iu dha e drejta e aksesit në e-mail-et zyrtare të Kryeministrit dhe të qeverisë së një vendi anëtar të NATO-s. Për këto duhet të përgjigjet sot Edi Rama, para deputetëve dhe shqiptarëve dhe të tregojë se ku shkuan këto para dhe nga u morën 225 mijë dollarë, të cilat Agron Neza, në datën 5 tetor të vitit 2017 ia dha në një parkim McGonigal-it. Për çfarë u dhanë këto para? Për të likuiduar opozitën, si shpërblim për të punuar kundër opozitës, kundër PD-së. Edi Rama duhet të japë shpjegime, por nuk guxoi të flasë për takimin e dytë mes McGonigal-it dhe atij në Shqipëri.

Përsëri, CEO-ja i kompanisë kineze nën sanksionin e SHBA-ve ishte interlokutor dhe i pranishëm. Duhet të japë llogari se çfarë u diskutua dhe çfarë prapaskenash u kurdisën në atë takim. Edi Rama duhet të sqarojë pse nuk ishin njoftuar institucionet amerikane për këtë takim me një zyrtar të lartë të FBI-së. Çfarë i fshehën, McGonigal-i dhe Edi Rama, qeverisë amerikane me këtë takim? Nuk guxoi

ta thoshte, vetëm thoshte: “Po, e kam takuar”. Pse e takove dhe çfarë bisedove? Çfarë kurdise? Kush e rekrutoi njëri-tjetrin? Ti atë, apo ai ty? Ai mendon se, duke luajtur rolin e strucit këtu, do t’i shpëtojë drejtësisë amerikane. Jo, jo, dy vjet e gjysmë ka zgjatur deri tani hetimi para se të dalë subpoena, dy vjet e gjysmë, dhe ju garantoj që edhe telefoni i inkriptuar, që ka përdorur Edi Rama, një telefon që e përdor vetëm mafia, për të biseduar me McGonigal-in, është i zbërthyer atje, prandaj sot ishte i vdekur i pakallur. E patë që kishte një çehre të verdhë, si një i vdekur i pakallur. Edi Rama e di shumë mirë që ka mbaruar politikisht, kurse ju i shërbeni, bëni gjithçka, bëheni kamikazë të tij, por ai politikisht ka vdekur, ai nuk do të jetë më Kryeministri i Shqipërisë, por në çdo rrethanë ai duhet të japë llogari këtu, para shqiptarëve, sepse do të shkojë para drejtësisë amerikane. Çfarë diskutoi më 22 28 janar të vitit 2018? Çfarë diskutoi më 20 dhjetor të vitit 2017, kur u takua në SHBA me McGonigal-in? Çfarë lidhjeje kishte Louis Bladel, i cili u ftua aty dhe iu dha një tender, që nuk u bë publik, megjithëse KLSH-ja, në atë kohë, e atakoi si një tender të paligjshëm, abuziv dhe korruptiv? Pse nuk është bërë publik? Pse fshihet? Pse nuk u thuhet shqiptarëve? A është Kryeministri i shqiptarëve ky, apo çfarë është? A ka për detyrë t’i informojë shqiptarët? Ai e di se ku ka shkelur, e di që ka hyrë në një varr politik nga i cili nuk del dot. Edi Rama duhet t’u thotë shqiptarëve se çfarë e lidh me oficerin e ish-Sigurimit të Shtetit, Agron Neza? Çarë mund të bëjë oficeri i ish-Sigurimit të Shtetit, Agron Neza, në zyrën e Kryeministrit pa asnjë atribut politik apo zyrtar? Edi Rama duhet t’u sqarojë shqiptarëve, këtu, se në SHBA do të japë llogari, se cili ishte pazari mes tij dhe McGonigal-it për të futur Deripaskën në biznese dhe për t’i dhënë rolin e investitorit strategjik, i cili ishte nën sanksione në SHBA?! Kësaj nuk i shpëton dot Edi Rama, sado të përpiqet këtu të bëjë hartime dhe të largohet. Atë nuk e shpëtoni dot as ju, zonjë, sado të prishni seancat e parlamentit, nuk e shpëtojnë as deputetët dhe deputetët këtu, të cilët i ka shndërruar në skllëvër, as ky ekipi këtu e asgjë.

Sot, Edi Rama ishte një kufomë politike, ndaj bëni çfarë të doni, por duhet të keni parasysh se Kushtetuta e këtij vendi e njuh komisionin hetimor dhe ju nuk keni asnjë shans që të mohoni të drejtën për një komision hetimor. Pse? Sepse është kapur në flagrancë. Por ai tha sot “Jam i pastër”, kështu që le t’i nënshtrohet komisionit. Nuk mund të ndryshoni Kushtetutën për të mbrojtur Edi Ramën, se është i pambrojtshëm, dhe po ju them që në varrin politik, ku ai do të shkojë, po vazhduat kështu, do t’ju marrë me vete të gjithëve. U mundua të ironizojë protestat tona... Lindita Nikolla – Mbaroi koha. Flamur Noka – Edhe një minutë. Po moj zonjë, po, revolucion demokratik! Do të hakërrehen, të jeni të sigurt, se një njeri që është edhe antiamerikan, edhe antishqiptar, nuk mund ta pranojnë shqiptarët kurrë më që t’i përfaqësojë për asnjë moment. Ndaj u bëj thirrje shqiptarëve të dalin nesër, në orën 12:00, në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, për t’i thënë këtij antishqiptari dhe antiamerikani se ora e tij ka mbaruar, sepse ai nuk po rresht së punuari për skenarin e tij.